



Në bazë të kërkesës së Komunitetit të fshatit Rastavicë të dt.11.02.2016, nr.01-4141, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e një objekti të përbashkët për nevoja të fshatit, duke u bazuar në nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 25 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.29.02.2016, bie këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË PËRBASHKËT PËR NEVOJA TË FSHATIT RASTAVICË

I.

Caktohet lokacioni për ndërtimin e një objekti-shtëpie të vogël të përbashkët për nevoja të gjithë komunitetit të fshatit Rastavicë, në një pjesë të parcelës nr.0158-0, Çertifikata P-70505065-00158-0, kullosë e klasës 1, vendi i quajtur Arat mi ulice, Zona Kadastrale Rastavicë, me sipërfaqe të përgjithshme 3574 m², e evidentuar si pronë komunale.

II.

Implementimin e këtij Vendimi do ta bën Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Deçanit.

III.

Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

IV.

Me Vendim njoftohen Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Arhivi i KK Deçan.

01.Nr.II-5

Deçan, dt.29.02.2016

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Jashar Dobraj

